



PROCESVERBAL 4/2025

I Mbajtur në takimin e IV-të të rregullt të KPF-së me datën **28.04.2025**, në ora **10⁰⁰** në Zyrën e takimeve të Kryetari i Komunës, nën kryesimin e Kryesuesit të KPF-së Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtares për informim.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. Xhavit Zariqi, Kryesues;
2. Arian Imeri, Anëtar
3. Lumnije Morina, Anëtare;
4. Mimoza Pajaziti, Anëtare;
5. Lulzim Abazi, Anëtar;
6. Brahim Osmani, Anëtar;
7. Shqipe Jashari, Anëtare;
8. Hatixhe Bungu Qerimi, Anëtare;
9. Flamur Istrefi, Anëtar.

Drejtori i drejtorisë;

1. **Sabri Murseli** – Drejtor i Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë;
2. **Arber Bytyçi** - Drejtor i Urbanizmit dhe Mjedisit;
3. **Kemajl Emini** - Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Përshëndetje të pranishëm, anëtarë të KPF-së, shoqëria civile, Drejtor të drejtorive, pra po fillojmë me mbledhjen e IV-të të rregullt të KPF-së, besoi që materialin e keni marr me kohë dhe ju dëshiroi mirëseardhje në mbledhjen e KPF-së dhe propozojë këtë rend dite:

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KPF-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KPF-së;
4. Propozim – Vendim për daljen në diskutim public të Draft Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt, si dhe Draft Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) planeve Ndërkomunale për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Komunat e Gjilanit, Kamenicës, Vitisë, Novobërdës, Parteshit, Kllokotit, Ranillug, Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Han i Elezit, Shtërpçë, Kosovë;
5. Propozim-Vendim për shfuqizimin e Vendimit 01. Nr. 147 datë 25.09.2017 për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2017-2025 të Komunës së Ferizajt;
6. Raporti financiar për periudhën Janar - Mars 2025;
7. Propozim - Vendim për Miratimin e lirimit nga pagesa e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, për shërbimet që ofrohen në Spitalin Rajonal, QKMF-së si dhe institucione tjera shëndetësore;
8. Propozim - Vendim për Miratimin e plotësimit ndryshimin e Memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Komunës së Ferizajt dhe Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve “ Shtëpia Ime” Ferizaj me Nr. 60/23 me datën 21.12.2023, për dhënien në shfrytëzim të ngastrës me Nr.638-0, Z.K. Zaskok dhe
9. Të ndryshme.

Pika 1

Kryesuesii KPF-së Xhavit Zariqi – Fillojmë me pikën e I-rë të rendit të ditës, Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KPF-së, të gjithë jemi prezent.

Pika 2

Kryesuesii KPF-së Xhavit Zariqi – A ka dikush të diskutoi rreth rendit të ditës?

Sabri Murseli –Drejtori Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë, propozoi këto pika shtesë për rend të ditës:

1. Propozim – Vendim për plotësim ndryshimin e Vendimit me Nr. 01.Nr. 24 të datës 25.03.2021 i plotësuar me vendimin 01.Nr. 68 datë 31.03.2022;
2. Propozim – Vendim për dhënie të pëlqimit N.P.L. “Ambienti” SH.A. për dhënie në shfrytëzim të njërive kadastrale 2025-0, 1038-0 dhe 1039-2 Z.K. Ferizaj;
3. Propozim – Vendim për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pjesës të ngastrës kadastrale 719-0 dhe ngastrave kadastrale 715-2, 715-3,704-0, 708-0 dhe 714-0 Z.K. Cernillë;

4. Propozim – Vendim për shpallje interes I pergjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale 777-15 dhe 777-6 Z.K. Dremjak prona private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 736-0 Z.K.Dremjak, pronë e Komunës së Ferizajt.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës.

Pika 3

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluar të KPF-së; a ka dikush ndonjë vërejtje rreth procesverbalit të mbledhjes së kaluar, siduket jo, a jeni që të kaloi procesverbali i mbledhjes së kaluar?, faleminderit, 8 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra miratohet procesverbali, vazhdojmë me pikën e IV-të të rendit të ditës.

Pika 4

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për daljen në diskutim publik të Draft Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt, si dhe Draft Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) planeve Ndërkomunale për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Komunitetet e Gjilanit, Kamenicës, Vitisë, Novobërdës, Parteshit, Klllokotit, Ranillug, Ferizajt, Kaçanik, Shtime, Han i Elezit, Shtërpçë, Kosovë, mbasi është për diskutim publik po e votojmë për kuvend dhe mbas diskutimit publik japim vërejtje dhe sygjerrime, a jeni që të kaloi në kuvend?, faleminderit, 8 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e V-të të rendit të ditës.

Pika 5

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim -Vendim për shfuqizimin e Vendimit 01. Nr. 147 datë 25.09.2017 për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2017-2025 të Komunës së Ferizajt;

Arbër Bytyqi – Përshëndetje për të gjithë, përshëndetje anëtarë të KPF-së, kjo pikë ka të bëjë me shfuqizimin e këtij vendimi, që ka ardhur prej Gjykatës; Propozim-Vendim për shfuqizimin e Vendimit 01. Nr. 147 datë 25.09.2017 për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2017-2025 të Komunës së Ferizajt dhe si çështje procedurale duhet të procesohet edhe me anulimin PZHK-së 2017-2025 edhe ashtu ne si komunë jemi duke u përgatitur për procedurat e Hartimit të Planit të ri të PZHK-së 2025-2033, faliminderit.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi –Faleminderit drejtor, dikush tjetër?

Brahim Osmani - Faliminderit kryesues, është shumë interesant dhe është e mirë nga qytetarët e komunës sonë, që po vjen një propozim vendim i tillë, ndërsa propozimet dhe tentimet e kryetarit të komunës kanë qenë gjithë në vitin 2017 që të rregullohet dhe të bëhen intervenimet e tij, duke ju treguar qytetarëve tonë që 8 vjet shkatrimin e qytetit që ju ku keni desht keni punuar me PZHK-në, edhe ju keni lëshu leje ndërtimit, për shkak që ne e dimë që bizneset jo që për

shkak të fajit të tyre, por që komuna ka lëshu leje jashtë ligjshëm të ndërtimit, barën e këtyre dhe përgjegjësi për shkatërrimin e qytetit kush ka me i marr, e tash në bazë të kësaj jeni tu përballë me gjukata për shkak të lejeve të ndërtimit, tjetra, para 3 apo 4 muajve nënkryetari i komunës del dhe thotë që gjukata na ka pezullu vetëm një pjesë të PZHK-së, tash del në ankand që gjykata e ka pru pezullimin PZHK-së komplet, a mundeni me majt qëndrim, a dini se çfarë çëndrimi keni me marr, dhe çfarë keni mi thanë qytetarëve të komunës sonë që 8 vjetë i keni shkatru këtë qytet dhe keni lëshu leje ndërtimore, apo kujna i ka konvenu kjo, për interesa të kryetarit apo kujna i ka konvenu kjo, ne si VV e kemi paraqit edhe kundra kuvendit se jena kanë kundër të kësaj PZHK-je, atëherë edhe në kohë të LDK-së, dhe se premtimi i juaj se ju keni me ndryshu këtë PZHK, nuk keni ba asnjë dryshim, dhe po përfundon mandati, po bëhen 8 vjet, që ju nuk keni ba asnjë ndryshim, po keni punuar vetëm duke bërë ate kurdo që juve ju ka konvenu, na si VV jena për PZHK-në edhe këna qenë më herët, por kur keni lëshuar vendime të jashtë ligjëshme na e kemi qar lëndën në gjykatë, e që po vjenë në përfundim që VV-ja ka pasur të drejt vazhdimisht, dhe se kemi tregu me kohë që na e kemi në rregullë, e ju e nuk e keni në rregulle, na i këna lëshu leje jashtë ligjshëm.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi –Më së pari kam drejtë ta marr fjalën, Brah ndroje këtë fjalor, që thua ju e keni shkatru sepse ky qytet u zhvillu jo për 7 vjet po që 20 vjet e ma shumë, se çdo qytet tjetër në Republikën e Kosovës, edhe haroni këto sene dhe mos folni pa lidhje, sepse nuk ka kuptim me thanë kështu qysh po thua t’I, PZHK nuk mundesh me ndryshu për 8 vjet, kurrkush, sepse është e rregullume, miratimi i PZHK-së, për 8 vjet nuk ka pasur kurkush ndërhyrje asnjë parti politike, e asnjë komunitet, e asnjë kryetar në asnjë objekt, edhe bindu njëherë e përgjithmon që kjo që e ka ba gjykata është palidhje krejt sepse veprimet funksionale në hapësirën e Komunës së Ferizajit për 7-8 vjet janë ba në bazë të PZHK-së, gjykata ka marr vendim të kotë sepse afati i PZHK –së s’kadon në këtë vit, edhe komuna është duke e përgatit PZHK të ri, edhe nuk ka kuptim me u thirr me këtë fjalor, e kanë shkatru e kanë shkatru edhe kanë marr leje për shokë, miq, e për jarana, lejet janë dhanë për qytetarët e Komunës së Ferizajt, ky qytet është i gjithëve nuk është i një kryetari ose një partije ose i një individi, zhvillimet që janë ba në Ferizaj, janë të jashtëzakonshme, nuk ka kuptim me u thirr në këto gjana dhe fjalor që të depërtoni pavarsisht të shfaqizimit të këtij vendimi, gjendja në teren nuk ndryshon, s’ka mundësi me ndryshu, keq e mire është ba qashtu, kushdo që ta harton PZHK-në të ri, prap ka me pasur paknaqësi, nuk ka mundësi me plotësu PZHK-në për 8 vjet të ardhëshme për me mujtë me ja plotësu dëshirat të gjithë qytetarëve, është e pa mundur, o merre kanë të duash, eksperta, e prap ka me pas vërejtje për PZHK-në, sepse ndryshojnë në afat kohorë gjatë periudhave të zhvillimit, ka me pas ambicje tjera, ka me pas ide tjera nuk ka me pas mundësi me i fut në PZHK, edhe këto sene duhet mi harru e me ba akuza, e fundi i fundit PZHK-ja është miratu në kuvend, është miratu në ministri edhe është kanë i ligjëshëm, gjykata ja ka fut kotë, a dinë shka d.m.th kjo, se ata nuk e dinë absolutisht qysh zhvillohet komuna, cilat janë vendimet që mirren në kuvend edhe që aprovohen në qeveri, ose në ministri përkatëse, edhe mbas 8 vjete thotë është i pa ligjëshëm, hajde ta ndryshojmë pra, shka u ba që 8 vjet e këndeje duhet krejt me i shkatru, me i prish, me i anulue dhe kurgja, qysh po mendon, kush i kompenzon, tash nuk muj me ja prish kërkujt shtëpinë ose banesën, ose qerdhen, duhet me i prish, edhe gjykatës ju ka ba një ankesë dhe merre një vendim, me pas marr vendimin në kohën kurr është miratuar PZHK-ja pas dy muajve kena mujt me rishqyrtu, po tash po thuni me ba ndryshim, çfarë ndryshimi e pat, është e pa mundur me ndryshu, i anulon veprimet e kurkush kurkujt, çfarë ndryshime bane, është e pamundur me i ndryshu, na tash jemi në fazën e hartimit të PZHK-së të ri, kur të mirret aprovimi

e shohim a duhet me anulë, apo me pezullë vendimin, PZHK-ja 2017 po thuani krejt e palogjikshme, e pamundur me ndryshu diçka në teren, nuk kanë dhe nuk është mirë me u thirrë vetëm në akuza, është e pamundur me marrë bazë sa u zhvillu ky Ferizaj, për 10 apo 20 vjet mbas lufte nuk është zhvillu asnjë komunë, mos u thirrni gjithmonë betonizim, betonizim, si t'ia nisë Pleshin, Jezerc, Fushë të madhe, Sllakovic, po kurkund në qendër të qytetit nuk ka gjelbërim në kuptimin që thoni ju, shkoni ku doni në Europë, kurkund nuk ka gjelbërim vetëm ndërtesa, periferi e ka parkun, megjithatë na nuk dojna me u ba si qytetet në Europë, se jemi qytet i vogël, mini qytet, nuk ka kuptim gjithmonë me u thirrë në akuzë të pa bazë, në vend që ju duhet me thanë shqyr që ky qytet u zhvillu, ky popull ka pas aftësi me investu, këtu qytetarët janë shpirt të punës, janë biznesmenë, janë investitor, kanë bashkëpunim me institucionin e komunës, është ndërtu infrastruktura, është thirrë qytet i biznesit, e jo mu thirrë shkatrim, shkatrim, syt janë me pa, ai që ka sy e she, a është shkatru apo është ndërtu, duhet me i haru do sene, na deshtëm apo nuk deshtëm, vendimi është për shfuqizim, që realisht i ka kalu afati.

Brahim Osmani – Kryesues propozojmë që ne jemi kundër biznesit, duhet me kuptu këtë senë, bizneset nuk e kanë pas asnjë pikë të fajit kurr, kanë ardhë për me marrë leje se kanë të drejtë.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Edhe na kena obligim me ju dhanë leje.

Brahim Osmani – Po duhet pak mi këqyrë qysh po i japim leje, se ka ndërtesa që nuk mujnë me hjek asnjë, as ambullantën në qytet, nuk po del asnjëherë grup parlamentar për me thanë se na jemi kundër ndërtimeve.

Arian Imeri - Ju po doni me dal se na jena kundër ndërtimit. mos ba propaganda.

Brahim Osmani – Ju po e pranoni që ka ndërtesa, që nuk po i plotësojnë kushtet, që sa e tha kryesuesi.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Unë nuk e di, po thash nëse ka.

Brahim Osmani - Pse e ke votu PZHK-në pra, e në atë kohë ka kaluar 2017, që jam kanë pjestar dhe jam marr me këtë punë, PDK-ja ka thanë është kontrabandore, se na e kena marr me ndryshim dhe e kena ba strikt, që 8 vjet ju keni punu me PZHK qysh ju ka konvenu juve.

Arbër Bytyqi – Nuk është nevojë me politizu, pse që kemi qenë kundër, kemi qenë vazhdueshëm në kundërshtim të kësaj PZHK-je dhe kemi edhe kërkesa të vazhdueshme që nga 2018 bile edhe për anulimin dhe shfuqizimin gjithë të PZHK-së nga ish drejtori paraprak, PZHK-ja është në fuqi në afat ligjor pasi që tha edhe kryesuesi 8 vjeçar, nuk mund ta ndryshojë askush, është ligji që e specifikon këtë çështje, normalisht është vendimi i gjykatës, është vendim përfundimtar dhe i apostrofon këto çështje tjera, ndërtues nuk janë vetëm të një partie politike, ka edhe të PDK-së, ka edhe të VV-së, ka edhe LDK-së edhe të AAK-së, që janë të afërt me të gjitha partit, pikë s'pari qytetarët e Komunës së Ferizajt edhe ne jemi të obligim t'i shërbejmë qytetarëve, PZHK duhet ta kuptojmë njëherë e mire, PZHK-ja bazë ka vetëm destinimin e tokës, kushtet ndërtimore asnjëherë nuk shtohen në bazë të PZHK-së, PZHK-ja është dokument strategjik i cili jep kahje dhe drejtim dhe në PZHK ekzistuese, ka qenë e përcaktueme vetëm destinimin e tokës, kushtet tjera janë përcaktuar në bazë të ligjit të ndërtimit të tokës, duke u

bazuar në specifika që i ka përcaktuar ky ligj i ndërtimit, ne mund ta politizojmë sa të dojmë këtë çështje, mirëpo kjo nuk është çështje politike, po është çështje teknike, pasi që ju e dini fort mirë që ne si drejtori kemi qenë shumë afër të hartimit të dokumentit tjetër të hartimit, mirëpo nga kjo qeveri është pëzulluar kjo e hartës zonanle, pa dashtë me i dhanë kahje politike, ne duhet t'i japim kahje teknike dhe të vazhdojmë me shfuqizimin e këtij dokumenti dhe komiteteve gjithë mbështetës të PZHK-së të ri, shpresojmë do të jetë një plan me i mirë se sa ky që e kena pasur deri më tani, faliminderit.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Urdhëro Arian!

Arian Imeri – Faliminderit kryesues, deshta me kundërshtu kolegën, që po duhet me bartë një përgjegjësi politike të PDK-së, në kohën kur ashtë aprovu PZHK-ja, kemi qenë kundër, e tani vendimi gjygjësor që ka ardh kundër dhe procedurat që janë hap, para se me u aprovu në kuvend d.m.th. i konteston ato procedura, e ne ato normal, na si parti nuk kemi marr pjesë, nuk është e vërtet që ka manipulu me opinionin publik, nuk është e vërtet që ka procese gjygjësore për leje që lidhet gjatë këtij mandatit, d.m.th. ne si parti jemi mundu dhe kemi ba disa ndryshime në fillim të mandatit të kalum d.m.th. në fillim gjatë Vitit 2018, 2022 gjatë këtij mandati, siç e dini kemi ndryshu ndestimin e projektit të spitalit, varrezat e qytetit, i kemi ba disa ndryshime, e në momentin kur VV-ja ka ardhë në pushtet, ne asnjë ndryshim nuk kemi ba, pra ashtë respektu prej nivelit qendror kjo PZHK-ja, d.m.th 100%, nuk e di a ke fol me ata në qendër, ata e kanë respektu PZHK-në dhe e kanë blloku zhvillimin e Qytetit të Ferizajit sa kanë mujt duke u thirr në PZHK-në, është mirë që ka ardh koha me u ndryshu dhe se nuk ka njëfarë peshe ky vendim që jeni tu e marr, afati i këtij vendimi është skadu, prandaj mirë që jemi kundra këtij vendimi, faliminderit.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Urdhëro Flamur!

Flamur Istrefi – Faliminderit kryesues është e vërtet që PZHK-ja është hartuar në kohën e qeverisë tonë, e ka qenë plan 8 vjeçar, është fakt që tha drejtori që përveç PZHK-ja dhe qenë edhe plani që të bëhen edhe harta zonale por kanë dështuar qe 8 vite e nuk janë janë ba hartat zonale, kjo është procedur shfuqizimi i këtij vendimi dhe unë besoi që përmu nuk është respektu PZHK-ja her e shtin në ligj të ndërtimit e në raste të veqanta është thirr me PZHK, sa I përket degradimeve është degradu ky qytet me gabime, me i ik temës që është zhvillu qyteti, po në fakt është zhvillu, por në fakt ndërtimet që janë ba nuk jena kundër, po janë ba pa asnjë metër gjelbërim, kena që pronën komunale e kanë shfrytëzu për mbindërtim dhe mendoj që duhet me pas përgjegjësi për këtë që nga qeverisja e jonë e deri te këto vite që kanë kalu, duhet me pas njerëz përgjegjës moral për këto vite që ka ndodh kjo, unë si kuvendar bësojë që nga ky shfuqizim që kena me ba kena me nisë për leje ndërtimore, me ba çmos me rregullu ku ka mangësi ligjore pjesë të këtij degradimi, faliminderit.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Dikush tjetër?, nëse nuk ka, a jeni që të kaloi në kuvend kjo pikë për për shfuqizimin e Vendimit 01. Nr. 147 datë 25.09.2017 për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2017-2025 të Komunës së Ferizajt, faleminderit, 8 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra miratohet shfuqizimi i vendimit, vazhdojmë me pikën e VI-të të rendit të ditës.

Pika 6

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2025; a ka dikush te diskutoi apo te kaloj për kuvend, faliminderit, 8 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra miratohet për kuvend, vazhdojmë me pikën e VII-të të rendit të ditës.

Pika 7

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim - Vendim për Miratimin e lirimimit nga pagesa e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, për shërbimet që ofrohen në Spitalin Rajonal, QKMF-së si dhe institucione tjera shëndetësore, a ka dikush te interesum për diskutim?, urdhëro drejtor!

Kemajl Emini– Faliminderit kryesues, pershendetje për të gjithë, anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, e kemi një kërkesë nga sindikata e policisë për lirimimin nga pagesat e policëve anëtarë të ngushtë të familjes, për arsye se policija nuk ka sigurime shëndetësore dhe kanë punë specifike të rrezikshmërisë të madhe ndaj sigurisë, unë për vete jam pro të kësaj kërkesë, po ata realisht e kanë ba kërkesën në spitalin rajonal, por kompetencat janë në shëndetësin primare, pra shërbimet do të kryhen vetëm në shëndetësinë primare, faliminderit.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Drejtor nuk e pata te qartë, a është vetëm për policin apo për anëtarë të familjes?

Kemajl Emini – Policija dhe për anëtarë të ngushtë të familjes.

Arian Imeri – Drejtor unë personalisht mbasi nuk janë mediat, nuk deshta me ba problem po nuk janë rast social, po si me marr vendim se si e kanë në veçanti, ka edhe të tjerë që punojnë, larg të qoftë nëse plagosen, e për një grip le të paguajnë si të tjerët, po më vjenë keqë unë nuk e marr për obligim këtë punë,

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Tjerë a ka për diskutim?

Mimoza Pajaziti - Megjithëse nëse ka ba kërkesën vetëm policija, pra edhe institucionet tjera munden me u përfshi, nëse i ipet një vendim i tillë duhet t'i përfshijnë të gjithë këta, atëherë realisht edhe FSK-ja dhe zjarrëfiksat që janë faktor të shtetit, është mirë mos të dalim edhe na keq nga kuvendi, nëse i ipet një gjë e tillë, t'i përfshi të gjitha këta, propozimi im është ky.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Ky është një pozicion i vështirë për neve, nuk je që e refuzon e as qysh e pranon, me pranë është e pa drejtë për të tjerë, na nuk mundemi me shkel te drejtën e dikujt tjetër, nuk janë kumedit çfar shërbime apo pagese në QKMF për shërbime që ju afrohen, nuk janë të pa përballueshme nën një, nën dy është e pa drejtë për familje, nuk ka asnjë logjikë edhe të tjerët janë qytetar të këtij vendi, edhe të tjerët shërbejnë dikund tjetër, nuk shërbejnë në politikë por edhe dikund tjetër, munden me thanë e kam vllaun polic e të kontrollohen pa pare.

Arian Imeri - Për familjar jam kundër.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - A ka mundësi Drejtor me shty këtë dhe me analizu ma detajisht, dalim keq, unë mendoj se dalim keq edhe politikisht edhe moralisht d.m.th. kundër tjerëve, nuk jam kundra po qysh me arsytet është problem.

Kemajl Emini - Është shqetësuese se kemi edhe kategori tjera, gjykata, zjarrfiksat etj, e nuk janë kumedit sa pagesa, se me ato pagesa po blejna barna esenciale, po po pak, po te na ka ardhë kërkesa dhe e kam për obligim me qit kërkesën, e bashkarisht vendosim.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Nëse na e miratojmë sot, na vijnë kërkesat prej tjerëve a mujna me refuzu?

Arian Imeri - Absolutikisht jo, qat mendim e kam edhe unë.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – A jeni që të shtyhet, A ka kundër jo, abstenim jo.

Pika 8

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim - Vendim për Miratimin e plotësim ndryshimin e Memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Komunës së Ferizajt dhe Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve “ Shtëpia ime” Ferizaj me Nr. 60/23 me datën 21.12.2023, për dhënien në shfrytëzim të ngastrës me Nr.638-0, Z.K. Zaskok, drejtor a mundesh me na sqaru?

Kemajl Emini - Realisht duke e lexu propozimin, është një propozim për dhënien në shfrytëzim të objektit me ngastrës me Nr.638-0, Z.K. Zaskok për 10 vjet me mundësi vazhdimi, organizata në fjalë ka ndikim me Organizatën Japoneze, KFOR-in Amerikan dhe ka kërkuar për ndërtim dhe zgjerim të objektit, është njësia për 10 vjet me mundësi të vazhdimit, besoi që është e arsyeshme.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - A është ajo pronë për shfrytëzim bile.

Sabri Murseli - Është pronë me mundësi zgjarimi për pronë për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve “ Shtëpia Ime” Ferizaj kundër dhunës në familje, ata kanë me renovu, kanë me zgjeru, është projekt 10 vjeçar, ka me shku përmes atyre, nuk i ipet prona me të drejta të plota, por vetëm si projekt në shfrytëzim, faliminderit.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Kush është që të kaloj?, Drejtor a mundesh tash me rend t'i jepesh propozimet.

Sabri Murseli - Materialet të gjitha ia përcjelli Leutrimin dhe ai i përcjellë në email. Kryesues po ja nisi prej propozimit të parë, Propozim – Vendim për plotësim ndryshimin e Vendimit me Nr. 01.Nr. 24 të datës 25.03.2021, i plotësuar me vendimin 01.Nr. 68 datë 31.03.2022, përmes së cilit është shpall interes publik disa njësive kadastrale 57-1, 57-2, 62-0, 63-0, 152-0 Z.K. Sazli dhe pjesët e ngastrave kadastrale 260-0, 259-1 Z.K. Papaz dhe 7 ari e 42 e kena propozu me një copë të parcelës kadastrale 350-0 Sazli me pronar Fahrije Sfarça mos

gabofsha ose me pjesën e ngastrës kad 992-1 Talinoc i Jerlive, janë marr Sazli – Papaz, unë kam ardhë me dy varianta cili të kalon këto e qojna për vlerësim.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - E vlerësojna në parim, kush është për faliminderit, 8 vota për, kundër 0, abstenim 0, kalon, vazhdojmë me pikën 10.

Pika 10

Sabri Murseli - Kryesues ky propozim ka të bëjë me Propozim – Vendimin për dhënie të pëlqimit N.P.L. “Ambienti” SH.A. për dhënie në shfrytëzim të njësive kadastrale 2025-0, 1038-0 dhe 1039-2 Z.K. Ferizaj, kërkesa ka ardhë me datën 29.04.2025 dhe ka të bëjë me pjesën e tregut të gjelbërt që e kanë me qira edhe me pjesën tjetër ngjit te “Orchide-ja” që janë disa kioska të vendosta, me ligjin me pronën publike thotë; në rast se i ipet për shfrytëzim prona ata kanë të drejtë me marr një pëlqim nga Kuvendi i komunës, kjo varet prej bordit, a ja japin për një vjet apo dy vjet.

Flamur Istrefi - Na që për këtë, kena dështu si komunë.

Sabri Murseli – Në qatë formë që e kanë me dhanë për shfrytëzim qysh e kanë pas.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - A jeni që të kaloi për kuvend Propozim – Vendimi për dhënie të pëlqimit N.P.L. “Ambienti” SH.A. për dhënie në shfrytëzim të njësive kadastrale 2025-0, 1038-0 dhe 1039-2 Z.K. Ferizaj, kush është për faliminderit, 7 vota për, kundër 1, abstenim 0, kalon, vazhdojmë me pikën 11.

Pika 11

Sabri Murseli - Propozim – Vendim për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pjesës të ngastrës kadastrale 719-0 dhe ngastrave kadastrale 715-2, 715-3, 704-0, 708-0 dhe 714-0 Z.K. Cernillë, kjo d.m.th. është për gurthyesin me dhanë me qira deri 15 vjet, një vendim paraprak me mujt me i’a dhanë komisionit, e tani del thirrja, kjo është afat shkurt, që e shini të arsyeshme për me i’a dhanë e që e sheni të pa arsyeshme kjo del prej janarit e tutje d.m.th. nuk ka afat ligjor, e kena pas për 30-40 vjet e kena kthy deri 15 vjet, për 15 vjet mujna me shpall, për shkak licencave dhe afateve ligjore deri 15 vjet po me qira afat shkurtër.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - A jeni aqë të kaloi, faliminderit kush është për faliminderit, 5 vota për, kundër 2, abstenim 1, kalon, vazhdojmë me pikën 12.

Pika 12

Sabri Murseli – Peticioni i Komogllavës.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Me më ngu mu drejtor, ky propozim mundet mos me dal në kuvend, se nuk ka logjikë, ata nuk kanë logjikë, ata me ardhë me u anku, edhe në mbledhjen tjetër e patëm këtë pikë dhe tham se është vendim i kuvendit dhe mos u merrni me këtë punë se

unë i kam pa do probleme te ta, se ma shumë kanë pas do inate personale, e tash kuvendi me inate personale me u marr nuk shkon.

Sabri Murseli - Kryesues a ta marr përsipër ta marr ta qes një ekipë, ta shohim a po bahet për të pame apo po bllokohet e pamja, që mos tja majmë anën njanës palë, ta qesim një gjeodet ta shofim ku qëndron objekti, a bllokohet.

Flamur Istrefi – Këtë analizë u kanë duhtë me ba ma herët.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Është pa lidhje që kuvendi me u marr edhe një herë për këtë çështje, kur njëherë ke ku vendim, dhe se ky vendim ishte i kuvendit, e ju merruni vesh si të doni dhe bani zgjidhje, e tash mbas një muaji edhe një herë me dalë diqysh, nuk po më duket e drejt.

Sabri Murseli - Ka një pjesë të mjaftueshme edhe për parking diqysh si në mes dhe me ja kthy.

Arian Imeri – Aty ka varreza.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Ju ka m'tek atyre me thanë ka varreza, po nuk kish.

Sabri Murseli - E kena një kërkesë për zgjerimin e varrezave në Komogllavë një hektar e diçka edhe një petition i banorëve, jena fokusu që të gjitha varrezat me i ba me një vend te qajo lagjja, por për momentin janë shfrytëzu parcelat për banesa qe 15 vjet d.m.th. nuk janë varros qe 15 vjet asni aty, unë po e baj një analizë në kuvend.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - A pati diçka tjetër?

Sabri Murseli - E pata qëto të Dremjakit, po kjo nuk është pregatit si duhet.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Bane gati për kuvend, e nëse nuk e banë kurgja kurkujna.

Procesmbajtësja



Zyliha Tafarshiku



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi